

## 5. Përfundimi dhe propozimi (titulli i cili propozohet)

(Anetarët e Komisionit vlerësues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim të shkurtër për titullin i cili propozohet. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë propozimin e tyre vetëm për një kandidat për një pozitë (ose për më tepër kandidatë, nëse ashtu është kërkuar me konkurs). Komisioni vlerësues përmbledh të dhënat për kandidatët që kanë aplikuar dhe sjell konkludimin dhe propozimin e arsyetuar për kandidatin dhe titullin në të cilin propozohet (sipas kërkesave të konkursit, Statutit dhe pozitës së shpallur) për kandidatin i cili propozohet për pozitën e shpallur. Kjo pjesë e raportit është e përbashkët për të gjithë kandidatët, ndërse 4 kapitujt paraprake shkruhen për secilin kandidat veç e veç (për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për aplikim sipas Statutit dhe konkursit).

Kandidati 1 dhe 3, në bazë të Statutit të përkohshëm të Universitetit publik të Mitrovicës nuk i plotësojnë kushtet – Neni 159 pika 2.

Kandidati 2, Sabrije Musa po ashtu nuk e plotëson kushtin sipas Statutit- nota mesatare në studimet master më e ulët se 8 (7.31).

Kandidati i 4 Arbër Zeqiraj, notën mestare në studimet bachelor e ka përafërsisht 8 (7.96), kurse atë të studimeve Master e ka mbi 8. (8.77).

Kandidatët Sabrije Musa dhe Arbër Zeqiraj kanë qenë edhe të angazhuar në cilësin e asistentit në Universitetin e Prishtinës.


Kandidati Arber Zeqiraj është autor kryesor i një abstrakti në konferencën shkencore ndërkombëtare në Takimin e IX (viti 2014) të Institutit ALB Shkenc.–

[http://iash-takimet.org/tv2014/programi/programi\\_natyra\\_2014.pdf](http://iash-takimet.org/tv2014/programi/programi_natyra_2014.pdf)

Komisioni recensues mendon se kandidati **Arbër Zeqiraj** i plotëson kushtet më së miri për zgjedhjen në thirrjen **Asistent për lëndët Fizika I dhe II** në Fakultetin e Gjeoshkencave të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.


Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:

1. Prof.Asoc.Dr. Naim Syla, kryetar



2. Prof.Ass.Dr.Shukri Klinaku, anëtar

3. Prof.Ass.Dr. Sefer Avdiaj, anëtar



Datë: 19/09/ 2014